

# 7 këshilla për të folur me fëmijun tuaj

Expertët pajtohen që shumica e fëmijëve që belbëzojnë përfitojnë nëse flasim me shpejtësinë që promovon rrjedhshmërinë. Këto udhëzime paraqesin disa mënyra se si mund të ndihmojnë të rriturit.

- 1. Zvogëlimi i shpejtësisë.** Flisni me fëmijun tuaj pa u ngutur, duke pauzuar shpesh. Prisni disa sekonda pasi të mbaroj fëmiju juaj para se të filloni të flisni ju. Të folurit tuaj të lehtë dhe të relaksuar do të ketë shumë më tepër efekt se sa këshillat si p.sh. “më ngadalë” ose “provoni përsëri më ngadalë”. Për disa fëmijë, është e dobishme për të pasur një dinamikë më të relaksuar të jetës për disa kohë.
- 2. Dëgjimi i plotë.** Tentoni të shtoni kohën që i'a kushtoni me vëmendje të pandërprerë dhe dëgjim të plotë fëmijut tuaj. Kjo nuk do të thotë që ta aplikoni gjatë tërë kohës.
- 3. Pyetjet.** Pyetjet janë një pjesë normale e jetës – por tentoni që të rezistoni për të bërë pyetje njëra pas tjetrës. Nganjëherë është më e dobishme të komentoni atë çfarë ka thënë fëmiju dhe të prisni.
- 4. Pritja e rradhës.** Ndihmoni të gjithë anëtarët e familjes të presin rradhën për të folur dhe për të dëgjuar. Fëmijët e kanë më të lehtë të flasin kur ka më pak ndërprerje.
- 5. Ndërtimi i vetëbesimit.** Përdorni lëvdata përshkruese për të ndërtuar vetëbesimin e fëmijut. P.sh. “Më pëlqen mënyra si po i mbledh lodrat. Ju jeni shumë i dobishëm”, në vend të “shumë mirë”. Lëvdoni aftësitë që nuk kanë të bëjnë me të folurit si p.sh. aftësitë atletike, të qenurit të organizuar, i pavarur ose i kujdesshëm.
- 6. Koha e posaqme.** Ndani disa minuta në një kohë të rregullt për çdo ditë, kur ju mund t'i kushtoni vëmendjen e pandërprerë për fëmijun tuaj. Kjo kohë e qetë – pa TV, iPad ose telefon – mund të ndërtoj vetëbesimin për fëmijët e vegjël. Madje edhe pesë minuta në ditë mund të jenë të rëndësishëm.
- 7. Aplikimi i rregullave normale.** Disciplinoni fëmijun që belbëzon njësoj si çdo fëmijë tjetër, dhe njësoj si do ta disiplinoni nëse ai nuk do të belbëzonte. .



Shoqata Kosovare për Belbëzim  
[www.belbezimi.org](http://www.belbezimi.org)

 belbezimi